

Ziber Lata¹

UDC: 28-23:316.362.3

REFLEKTIVE KURANORE MBI FAMILJEN**КУРАНСКИ РЕФЛЕКСИИ ЗА СЕМЕЈСТВОТО****QUR'ANIC REFLECTIONS ON THE FAMILY****Abstract**

The family is one of the fundamental institutions of human life, and the Quran pays special attention to its structure, function, and the values that should guide it. This paper examines the Quranic reflections on the family, focusing on key concepts addressed in the Noble Quran, such as love, mercy, justice, and mutual responsibility among its members. By analyzing various verses, it explores how the Quran presents the family as a source of stability and spiritual development, emphasizing the importance of parent-child relationships, spousal relationships, and the role of the community in preserving familial harmony.

Through a hermeneutic-philosophical and linguistic approach, the study illuminates the ethical and practical dimensions of these teachings, proposing ways in which they can be applied in the contemporary context.

These reflections will be made in the light of the verses, their interconnection, and the context in which the family is addressed. From this, it will be understood that the family is the foundational basis upon which the faith of every devout believer is built.

Keywords: *family, Quran, hermeneutics*

Hyrje

Allahu i Lartësuar, kur flet për familjen, fillon me zanafillën dhe pikën fillestare të saj, ngase nëse ajo është e shëndoshë, atëherë edhe ndërtimi i mëtutjeshëm është i shëndoshë, funksional dhe frytdhënës:

¹ Profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Islame, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. E-mail: ziber.lata@gmail.com

“Ndër shenjat e Tij është që Ai krijoi për ju bashkëshortet nga vetë ju, që të gjeni prehje tek to, dhe vendosi mes jush dashuri dhe mëshirë...” (Er-Rum, 21)

Familja është një institucion natyral, i ndërtuar mbi baza thelbësore të ndërtimit shoqëror, dhe jo një institucion artificial i krijuar. Ajo është e sunduar nga vlera mëshirëdhënëse si mirëkuptimi, falja dhe përparësia, e jo nga natyra konkurruese dhe konfliktuale e marrëdhënieve të bazuara në ekuilibrin e forcave.²

Sigurisht që dimensionet që reflektojnë mësimet kur'anore për familjen janë të shumta dhe të shumanshme, mirëpo në vazhdim do të paraqesim vetëm disa dimensionet që kuptohen nga tërësia e kuptimeve kur'anore:

Familja është akt adhurimi

Shpeshherë nëpër diskutimet filozofike-ontologjike diskutohet se njëra nga vetitë më të spikatura të ekzistencës njerëzore është vetëdija e njeriut për familjen. Një qenie (njeri) që nuk është e vetëdijshme për përkatësinë familjare dhe rëndësinë që ajo ka në ekzistencë, atëherë vështirë se mund të perceptojë thelbin e asaj për të cilën është krijuar në këtë botë. Edhe gjallesat tjera kanë instinktin e njohjes së paraardhësit dhe të pasardhësit, por asnjëra prej tyre nuk është e vetëdijshme për këtë.

Megjithatë, këtu duhet të bëjmë një dallim mes asaj që pohon filozofia profane dhe filozofia e kultivuar nga muslimanët. Filozofia profane e trajton familjen si bërthamë e shoqërisë. Aristoteli e sheh familjen si një bashkësi natyrore që lind nga nevoja për mbijetesë dhe riprodhim. Sipas tij, familja është hapi i parë drejt formimit të qytetit (polis).³ Kanti e sheh familjen si çerdhe të moralit, ku njeriu i formon konturat e moralit të tij jetik.⁴ Këto dhe shumë pohime të filozofëve të tjerë janë shumë të rëndësishme, madje disa prej tyre përsëriten edhe nga filozofët muslimanë, kurse ajo që e dallon qasjen e filozofëve të tjerë nga qasja e filozofëve muslimanë është se këta të fundit kujdesin dhe edukimin në familje, krahas të tjerave, e konsiderojnë akt adhurimi, apo siç shprehet vetë Gazaliu: “edukimi i fëmijëve është një formë adhurimi dhe karakteri moral i prindërve luan një rol thelbësor në formimin shpirtëror të tyre”⁵ Pra, i gjithë procesi i mirëqenies së një familjeje të shëndoshë është një akt adhurimi në vete: edukimi, sjellja brenda anëtarëve të saj, kontributi material dhe shpirtëror, etj., të gjitha janë pjesë e këtij akti të

² Izzet Hibe Reuf, *El-mer'etu ve el-amel es-sijasijj (gruaja dhe aktiviteti politik)*, Instituti Botëror i Mendimit Islam, botimi I, 1995, f. 187

³ Aristotle. (1995). *The Politics* (E. Barker, Trans., R. F. Stalley, Ed.). Oxford University Press. (Original work written ca. 350 B.C.E.)

⁴ Kant, I. (1996). *The Metaphysics of Morals* (M. Gregor, Trans.). Cambridge University Press. (Original work published 1797)

⁵ El-Ghazali. *Ihja' 'ulum ed-din*. Bejrut: Dar el-Fikr, 2005, vëllimi III, f. 72

adhurimit, e i cili nuk është më pak i vlefshëm se adhurimet tjera, bile i pari për nga renditja.

Në momentin kur familja trajtohet si akt adhurimi, atëherë pa pikë dyshimi ajo trajtohet si element qenësor në ekzistencën e njeriut, sepse vetë njeriu është krijuar për adhurim: ***“Nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për asgjë tjetër përveçse të më adhurojnë.”***⁶

Tendenca për të rrënuar institucionin familje, në bazë të kësaj që u kuptua, është tendencë për ta tjetërsuar ontologjinë e njeriut, kurse ruajtja e familjes është gatishmëri për të konfirmuar ekzistencën e qenies njeri në Tokë.

Familja, parim qenësor i fesë islame

Vërtet Islami ka pesë shtylla kryesore, por vetëm disa studiues kanë spikatur rolin, rëndësinë dhe pozicionin e familjes në këto shtylla. Këtë shumë bukur e trajton studiuesi egjiptiano-amerikan Hamuda Abdulati në veprën “The structure of family in Islam”, ku shtjellon gjithë filozofinë e familjes dhe vendin që zë ajo në jetën e njeriut, bashkë me rëndësinë që ajo ka në strukturën e mësimave islame. Ndër të tjera, në një syth të veçantë shtron dilemën “A është familja njësi religjioze në Islam apo jo?” Autori, pasi thekson se familja parimisht nuk është shtyllë apo njësi religjioze e drejtpërdrejtë, ai përsëri e sheh shumë të rëndësishme familjen për vetë thelbin e fesë.⁷

Nëse shihen parimet themelore apo shtyllat e fesë, aty nuk e gjejmë familjen, por ndërlidhja aq e theksuar e familjes me të gjitha këto parime, familjes i jep një rëndësi të veçantë në gjithë ngrehinën e Islamit.

Po ashtu, nëse shihen dispozitat juridike islame që ndërlidhen me familjen, duke filluar nga respekti i fëmijës ndaj prindërve dhe deri te ndarja e trashëgimisë, e gjithë kjo mori rregullash juridike, e cila përbën një fushë të veçantë në jurisprudencën islame, lë të kuptohet se ruajtja e këtij indi shoqëror të quajtur familje është një detyrim i patjetërsueshëm fetar dhe më shumë se një njësi religjioze.

Sejid Husein Nasr e trajton familjen si një komponent thelbësor të rendit shpirtëror dhe etik të Islamit. Ai e sheh familjen si një institucion që pasqyron rendin kozmik dhe shërben si një mjedis për zhvillimin shpirtëror të individit.

Nasri argumenton se familja në Islam nuk është thjesht një bashkësi shoqërore, por një strukturë që reflekton parimet hyjnore dhe rendin e krijimit. Ajo është vendi ku individi mëson vlerat e sakralitetit, drejtësisë dhe dashurisë, duke u bërë kështu një qendër për formimin moral dhe shpirtëror.⁸ Nasri, siç shihet më lartë, familjen e ngre një shkallë më lartë, sepse të gjitha

⁶ Kur'an, surja Edh-Dharijat, ajeti 56

⁷ Hammudah AdbulAti, *The Family Structure in Islam*, Indianapolis, IN: American Trust Publications, 1977, f. 33

⁸ Seyyed Hossein Nasr, *Islamic Life and Thought* Nasr, State University of New York Press, 1981, shih: f. 46-56.

përkufizimet për familjen nga filozofët janë të përbotshme, kurse ai e ngre në nivelin e kozmosit, d.m.th. e trajton si një proces më të ndërlikuar dhe që e kapërcen të qenët vetëm proces i thjeshtë social dhe njerëzor.

Në kontekst të kësaj, Allahu i Lartësuar thotë:

“Dhe nga shenjat e Tij është se Ai ju krijoi prej dheu, pastaj, ja, ju jeni njerëz të përhapur (në Tokë) (20). Dhe nga shenjat e Tij është se Ai krijoi për ju, prej vetes suaj, bashkëshorte që të gjeni prehje tek ato, dhe vuri mes jush dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka, vërtet, shenja për njerëz që mendojnë (21). Dhe nga shenjat e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës, dhe ndryshimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja. Në këtë ka shenja për dijetarët (22).”⁹

Këto tri ajete, bashkë me disa ajete para dhe prapa, i numërojnë disa ajeh (mrekulli dhe shenja) të Zotit. Siç shihet në tri ajetet e dhëna më sipër, martesë dhe krijimi i familjes është vendosur në mes dy mrekullive më të mëdha: mes krijimit të njeriut dhe krijimit të kozmosit. Pra, familja është vendosur në qendrën e zhvillimeve kozmologjike dhe jo thjesht si një akt i rëndomtë tokësor. Po ashtu, vendosja e këtij ajeti në zemër të zhvillimeve kozmologjike, më saktësisht mes krijimit të njeriut nga dheu dhe krijimit të qiejve dhe të Tokës, tregon se familja është ajo që mban ekuilibrin (ontologjik) të krijimitarisë së Zotit.

Krejt kjo pasqyron faktin se familja në Islam nuk është shtyllë e fesë, por është djepi ku vendosen dhe peshojnë të gjitha urdhëresat dhe ndalesat fetare. Nëse shihet me vëmendje jeta e Profetit (a.s.), atëherë shihet se baza e çdo zhvillimi të thirrjes islame ishte në familje. Në rritjen dhe edukimin e Profetit Muhamed si fëmijë kishte dorë e gjithë familja dhe farefisi. Pastaj në momentin e parë të shpalljes, përsëri u kthye në familje, gjegjësisht te bashkëshortja e tij, Hatixha (r.a.). Kur e kërcënonin politeistët e Mekës, i dolën në krahë familjarët në krye me xhaxhain e tij, Ebu Talibin. Kur jobesimtarët e sulmuan pranë Qabesë, i doli në krah xhaxhai i tij Hamzai (r.a.). Kur mërzhitej për ndonjë punë të caktuar, kthehej në familje te bashkëshortet e veta për t’u qetësuar. Madje, aq shumë i kushtoi rëndësi familjes, sa që vendosi edhe të varrosej po në dhomën ku edhe jetoi bashkë me familjen e vet, sepse njeriu që nuk ka qetësi familjare, nuk mund të ketë qetësi as në jetën shoqërore dhe nuk mund të ketë perspektivë në përmasat tjera të jetës. Shkurt thënë, Muhamedi (a.s.) familjen e kishte bazamentin kryesor ku e vendosi ngrehinën madhështore të quajtur Islam.

Familja pjesë e shtyllave të fesë

Të gjitha dispozitat juridike, qofshin urdhëresa apo ndalesa, kanë në konsideratë të veçantë familjen si një ind i rëndësishëm i shoqërisë njerëzore, madje në shumë raste, kur vjen në pyetje interesi i institucionit familje, atëherë Allahu i Lartësuar ka përcaktuar lehtësime edhe për adhurimet.

⁹ Kur’an, surja er-Rum, ajeti 20, 21, 22

Një nga shtyllat e rëndësishme të fesë islame është falja e namazit. Nëse analizohet me shumë kujdes vendi i familjes në raport me namazin, do të del në shesh se ajo ka një rol tepër kyç në të. Për shembull, falja e namazit me xhemat është 27 herë më e vlefshme sesa falja individualisht, dhe namazi me xhemat nuk lëshohet përpos në ndonjë arsye më madhore, e pikërisht kjo arsye është kujdesi ndaj familjes. Studiuesit kanë dhënë mendime të ndryshme pse gruaja nuk e ka detyrim të falet në xhami, edhe pse i lejohet, ata kanë pohuar se arsyeja kryesore është kujdesi ndaj familjes, sepse ajo është menaxherja e saj. Nevoja dhe domosdoshmëria që dikush të kujdeset nga afër për fëmijët dhe për familjen, e ka bërë që gruaja të lirohet edhe nga namazi me xhemat, gjegjësisht të marrë sevapin e njëjtë si burri edhe kur falet në shtëpi. Pra, këtu shihet se familja ka një rol kyç edhe në raport me shtyllën e dytë të Islamit.

Humbjet në familje nuk ndreqen me gjëra të përbotshme, por me gjëra që tejkalojnë përbotshmërinë. Kur Muhamedi (a.s.) i humbi dy anëtarët më të ngushtë të familjes dhe dy përkrahësit më të denjë, Hatixhen (r.a.) dhe Ebu Talibin, atë vit e quajti “viti i pikëllimit” dhe nuk kishte asgjë në Tokë që mund t’ia shëronte këtë plagë, prandaj u desh të ngrihej në qiell. Pastaj, atje në qiell e mësoi namazin për t’i mësuar njerëzimit se namazi dhe familja janë dy qetësuesit dhe prehja më e mirë për çdokënd.

Sipas mësimave islame, zekati nuk u jepet anëtarëve të ngushtë të familjes (paraardhësëve, pasardhësve, as bashkëshortit apo bashkëshortes), kurse anëtarëve të tjerë (vëllezërve, motrave, xhaxhallarëve, dajallarëve etj.) u jepet.¹⁰ Të parëve është e ndaluar t’u jepet sepse ne e kemi detyrim kujdesin për ata, kurse grupit të dytë, përveç faktit që lejohet t’u jepet, madje këta kanë përparësi para nevojtarëve të tjerë, sepse Profeti (a.s.) ka thënë: “Sadakaja ndaj të afërmit ka dy shpërblime: shpërblimin e sadakasë dhe shpërblimin e mbajtjes së lidhjeve familjare (silatu rahim).”¹¹ Në këtë mënyrë, përmes institucionit të zekatit Allahu kërkon nga besimtarët të kujdesen për familjen: në rastin e parë kërkon kujdes që familjari të mos bie në nivelin e marrjes së zekatit, sepse përgjegjësia ndaj tyre është e drejtpërdrejtë, kurse në rastin e dytë, ku përgjegjësia nuk është e drejtpërdrejtë dhe ku më një i afërm ka rënë në kategorinë e atyre që u takon zekati, atëherë duhet që njëherë t’u jepet atyre dhe pastaj të tjerëve.

Agjërimi është adhurim që në të gjitha aspektet lidhet me familjen, sepse aty vjen në shprehje respekti ndërfamiljar, ngrohtësia dhe shumë aspekte të tjera. Më e rëndësishmja është se kurorëzimi i Ramazanit është festa e bajramit, ku thelbi është vizita e ndërsjellë mes familjarëve. Pastaj, përveç kësaj, Muhamedi (a.s.) ka stimuluar që këto raporte familjare, krahas shpërblimit në botën tjetër, kanë edhe efekte shëndetësore dhe ekonomike, sepse ka thënë:

¹⁰ Vehb Zuhejli, *El-fikh el-islamijj ve edil-letuhu*, vëllimi II, Damask, Daru el-Fikr, 2007, f. 824

¹¹ Muhamed bin Isa Tirmidhiu, *Xhamiu i Tirmidhiut*, vëllimi II, hadithi numër 658, Liban, Dar el-Kutub el-Ilmijeh, 2007, f. 42

“Kush dëshiron t’i zgjatet jeta dhe t’i shtohet rizku (furnizimi), le ta mbajë lidhjen farefisnore.”¹²

Shtylla e fundit e fesë islame është haxhillëku. Nëse shtrohet pyetja se çfarë lidhje ka haxhillëku me familjen, përgjigja është se haxhillëku është vetë familja, ndërsa arsyet do t’i tregojmë në vijim:

- Muhamedi (a.s.) e kreu haxhillëkun vetëm pasi i bashkoi medinasit me familjarët e tyre në Mekë, sepse çdo një haxhillëk pa afrim apo bashkim familjar do të ishte i pakuptimtë.

- Shtylla kryesore e haxhillëkut është qëndrimi në Arafat në Ditën e Arifes. Kush nuk qëndron në Arafat qoftë edhe për një moment të vetëm, nuk e ka kryer haxhillëkun. Madje Muhamedi (a.s.) për këtë ditë ka thënë: “Ajo është dita më e mirë që ka lindur dielli.”. Vallë, pse? Fjala arafat do të thotë njohje, dhe quhet e tillë sepse në atë vend dhe në atë ditë është takuar Ademi (a.s.) me Havanë (a.s.), pra në atë vend dhe në atë ditë është krijuar familja e parë në Tokë.

Lidhja e nyjave familjare në Kur’an

Kur’ani, bërthamën kyçe të shoqërisë e ka formuar duke i lidhur fuqishëm nyjat e saj, madje secilën prej tyre e lidh në një formë të veçantë, p.sh.:

- Kur flet për zotimin e martesës atë e quan “besëlidhje të fortë”, siç thotë në Kur’an: ***“E ato (gratë) kanë marrë nga ju një besëlidhje të fortë.”***¹³ Në asnjë vend të Kur’an fjalën *mithak* (besëlidhje) nuk e shoqëron me një mbiemër kaq domethënës dhe madhështor.¹⁴

- Kur flet për respektin ndaj prindërve, në shumë raste e shoqëron atë me respektin ndaj Tij (Allahut), p.sh. në suren el-Isra thotë: ***“Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Tij dhe t’u bëni mirë prindërve...”***¹⁵

- Kur flet për raportin prind-fëmijë, ka veçuar një sure të veçantë, suren Lukman, kurse personazhin që e ka këshilluar drejt fëmijën e ka cilësuar me urtësi, pra sikur na tregon të gjithëve se gjëja më e mençur në dynja është këshillimi dhe krijimi raporteve të shëndosha prind-fëmijë.

- Kur flet për anëtarët e afërt dhe të largët të familjes, na porosit që fillimisht të thërrasim në rrugën e drejtë ata dhe t’i shpëtojmë nga të këqijat,

¹² Muhamed bin Ismail el-Buhari, *Xhamiu es-sahih*, hadithi numër 5986, vëllimi VIII, Dar Ibn Kethir, 1987

¹³ Kur’an, surja en-Nisa, ajeti 21

¹⁴ Munijeh Taraz, “El-bina el-userij ve ehlijjetu ez-zevxhejn: mukarebetun sher’ijjetun mekasidijeh (Ndërtimi familjar dhe familjarizimi bashkëshortor: krahasim shariatik-intencional)”: në veprën: el-usretu el-muslimah fi dhil-li et-tegajjurat el-muasireh (familja muslimane në hijen e transformimeve bashkëkohore)”, Instituti Botëror i Mendimit Islam dhe Dar el-Fet’h, f. 223

¹⁵ Kur’an, surja el-Isra, ajeti 23

sepse kështu u urdhërua edhe Muhamedi (a.s.) në fillim të shpalljes: *“Dhe paralajmëro familjen tënde më të afërt.”*¹⁶ Po ashtu, në suren Tahrim thotë: *“O ju që besuat! Ruani veten dhe familjet tuaja nga një zjarr, lëndë djegëse e të cilët janë njerëzit dhe gurët. Mbi të janë melekë të rreptë e të ashpër, të cilët nuk kundërshtojnë Allahun në asgjë që Ai u urdhëron dhe zbatojnë gjithçka që u urdhërohet.”*¹⁷

- Kur Nuhu (a.s.) u lut për shpëtimin e djalit të tij jobesimtar, Allahu i Lartësuar i tregoi se nuk duhet të lutet edhe një herë për shpëtimin e dikujt që ka mohuar Allahun. Mirëpo në rastin konkret shtrohet pyetja: përse Nuhu e bëri këtë lutje, kur dihet se pejgamberët janë të pagabueshëm? Përgjigjja është se ky ajet nuk nënkupton gjykimin e veprimin të një pejgamberi, por instinktin e brendshëm që Allahu ka vendosur te çdo prind për fëmijën e vet dhe anasjelltas, gjë e cila i tejkalon kufijtë e bindjeve dhe besimeve.

Një shembull tjetër kuranor që e pasqyron rëndësinë e familjes është pohimi i bashkëshortes së Faraonit, Asijes, e cila i bërë këtë lutje Allahut: “O Zot, më ndërto tek Ti një shtëpi dhe më shpëto na faraoni dhe punët e tij, dhe më shpëto nga populli zullumqar!” Në kërkesën e Asijes shihen dy gjëra të rëndësishme: e para është kërkesa për t’u afruar tek Zoti, para se ta kërkojë shtëpinë, “më ndërto tek Ti një shtëpi” dhe jo “më ndërto një shtëpi tek Ti”. Dhe e dyta, pavarësisht se Asia jetonte në një kështjellë madhështore, ajo përsëri kërkoi një shtëpi, sepse fjala shtëpi këtu nënkupton familjen e shëndoshë dhe ngrohtësinë familjare, gjë e cila i mungonte në këtë botë. Përndryshe nuk ka logjikë që duke pasur kështjellë në këtë botë, të kërkojë diçka më të ulët (shtëpi) në botën tjetër.

Në fund, të gjitha nyjat kyçe të familjes, të cilat Kur’ani i ka lidhur përmes fjalëve mrekulluese dhe në forma të jashtëzakonshme, përbëjnë indin themelor shoqëror mbi të cilin pastaj duhet të implementohet i gjithë Islami, dhe kështu të përmbushet synimi për të cilin jemi krijuar, adhurimi i Allahut të Lartësuar.

Conclusion

From everything discussed above, it can be concluded that the family in Islam is not merely a social structure or a biological need of society, but an institution with ontological, ethical, and spiritual dimensions, placed at the very heart of the cosmic order of creation. It is not only the environment where a person is born and raised, but the first school of moral formation, the place where worship takes a concrete dimension through love, mercy, and mutual responsibility.

¹⁶ Kur’an, surja esh-Shura, ajeti 214

¹⁷ Kur’an, surja et-Tahrim, ajeti 6

As seen, the family is directly connected to all the pillars of the Islamic faith - from prayer, zakat, fasting, to pilgrimage - demonstrating that without this institution, there can be no preservation of religious values, no social stability, and no spiritual development. For this reason, preserving, protecting, and strengthening the family is a sacred mission and a consistent act of worship that gives meaning to all human existence and connects humanity with its divine purpose.

At a time when traditional concepts of the family are being challenged by various social and ideological trends, returning to Qur'anic principles for the family is not regression, but an effort to preserve human dignity and the harmony of creation. Because, according to Islam, the family is not just a matter of social regulation, but the very foundation upon which the structure of faith and civilization is built.

Literatura e konsultuar:

1. Aristotle. (1995). *The Politics* (E. Barker, Trans., R. F. Stalley, Ed.). Oxford University Press. (Original work written ca. 350 B.C.E.)
2. Ebu Hamid el-Ghazali. *Ihja' 'ulum ed-din*. Bejrut: Dar el-Fikr, 2005, vëllimi III
3. Hammudah AbdulAti, *The Family Structure in Islam*, Indianapolis, IN: American Trust Publications, 1977
4. Izzet Hibeh Reuf, *El-mer'etu ve el-amel es-sijasijj (gruaja dhe aktiviteti politik)*, Instituti Botëror i Mendimit Islam, botimi I, 1995
5. Kant, I. (1996). *The Metaphysics of Morals* (M. Gregor, Trans.). Cambridge University Press. (Original work published 1797)
6. Kur'ani fisnik, përkthimi i ajeteve është realizuar nga vetë shkruesi i këtij artikuli.
7. Muhamed bin Isa Tirmidhiu, *Xhamiu i Tirmidhiut*, vëllimi II, hadithi numër 658, Liban, Dar el-Kutub el-Ilmijeh, 2007
8. Muhamed bin Ismail el-Buhari, *Xhamiu es-sahih*, hadithi numër 5986, vëllimi VIII, Dar Ibn Kethir, 1987
9. Munijeh Taraz, "El-bina el-userij ve ehlijetu ez-zevxhejn: mukarebetun sher'ijjetun mekasidijeh (Ndërtimi familjar dhe familjarizimi bashkëshortor: krahasim shariatik-intencional)": në veprën: el-usretu el-muslimah fi dhil-li et-tegajjurat el-muasireh (familja muslimane në hijen e transformimeve bashkëkohore)", Instituti Botëror i Mendimit Islam dhe Dar el-Fet'h
10. Seyyed Hossein Nasr, *Islamic Life and Thought* Nasr, State University of New York Press, 1981
11. Vehb Zuhejli, *El-fikh el-islamijj ve edil-letuhu*, vëllimi II, Damask, Daru el-Fikr, 2007